



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 73/14

Nr. llog. / Br. si -1-

Data: / Datum 27.03.2014

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 40.2, "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 8 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla 01Nr 37-2/11 të datës 24.02.2011, si dhe kërkesës së Isa Hajrizit të dt. 14.03.2014, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.03.2014**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDIHMË FINANCIARE PËR SHËRIM**

**Neni 1**

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për subvencione për Isa Hajrizin, me banim në Vushtrri, në shumën prej 2.500 € (dy mijë e pesëqind euro).

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet për operim, me qëllim të shërimit të plagëve të luftës.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.


**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Shpëtim Zhegrova**





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 41.2 pika "ç" e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e mbajtur më 27.03.2014, mori këtë:

#### VENDIM

### PËR APLIKIM PËR GRANTIN E SHPALLUR NGA MINISTRIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL PËR PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË SISTEMIT TË UJITJES NË FSHATIN PANTINË

#### Neni 1

Komuna e Vushtrrisë merr obligim për participim me mjete financiare nga buxheti komunal në masën prej 20 % apo në vlerë monetare prej 28,931.07 €, nga vlera e përgjithshme e projektit "përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të ujitjes".

#### Neni 2


Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

#### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 41.2 nënpika "ç" të Statutit të Komunës, po ashtu në nenin 4, pika 3, nenin 5, pika 1.2, nenin 7, nenin 19, pika 3 dhe në nenin 23 të Ligjit për teatrot, Nr. 04/L-106, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.03.2014** mori këtë:

## **VENDIM PËR THEMELIMIN E TEATRIT TË QYTETIT**

### **Neni 1**

Me këtë vendim themelohet Teatri i qytetit të Vushtrrisë.

### **Neni 2**

Teatri i qytetit të funksionojë si institucion publik dhe veprimtarinë e vet ta zhvillojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për teatro, Nr. 04/L-106.

### **Neni 3**

**3.1.** Përbërja, organizimi i brendshëm, si dhe të drejtat dhe obligimet tjera që dalin nga veprimtaria e Teatrit të qytetit, do të përcaktohen me Statutin e teatrit, gjithnjë në pajtim me dispozitat e Ligjit për teatër.

**3.2.** Statutin e teatrit, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të teatrit, obligohet ta hartoj dhe propozoj brenda afatit tre mujor Këshilli drejtues. Këtë statut e miraton Asambleja Komonale.

**3.3.** Këshillin drejtues të teatrit e emëron dhe shkarkon Kryetari i Komunës.

### **Neni 4**

Teatri i qytetit të Vushtrrisë veprimtarinë e vet do ta zhvillojë në objektin e Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" në Vushtrri, ndërsa mjetet buxhetore me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë së tij, do të sigurohen në pajtim me ligjet në fuqi.

### **Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 6**

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Shqipërim Zhegrova**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	70/14
Nr. i fq. / Br. si	-1-
Data: / Datum	27.03.2014
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 13.1. pika "a" të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr.02/L-26, nenit 12.2 "d", 14.1 dhe 17.1 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.03.2014 mori këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZAT NË FSHATIN STROC

### Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për varrezat e fshatit Stroc pjesë nga parcela kadastrale P-70202017-00565-0 në sipërfaqe prej 7300 m<sup>2</sup>, në sipërfaqe të përgjithshme prej 102233 m<sup>2</sup>, me kulturë "kullosë" e klasës së 5-të, Zona Kadastrale Gllavatin, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 2

Obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destinimit të kësaj parcele në elaboratin kadastral nga kultura "kullosë" në kulturën "varreza", të përmendur në nenin 1 të këtij vendimi.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendim obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.


### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Shpëtim Zhegrova



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.03.2014, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis në Komunën e Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

### **V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis në Komunën e Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 28.03.2014 dhe zgjatë deri më 16.04.2014.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

#### **Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DUMM-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Prill 2014.

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 68/14

Nr. i fq. / Br. at -1-

Data: / Datum 27.03.2014

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **27.03.2014**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për organizimin e transportit në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK**

**Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për organizimin e transportit në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 28.03.2014 dhe zgjatë deri më 16.04.2014.

**Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerri masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

**Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Prill 2014.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

